




RAPORTI I MBIKËQYRJES | **2018**
SUPERVISION REPORT

TREGU I SIGURIMEVE, I FONDEVE TË PENSIONEVE VULLNETARE, I FONDEVE TË INVESTIMEVE
INSURANCE, VOLUNTARY PENSIONS FUNDS, INVESTMENTS FUNDS MARKET


PËRMBAJTJA

I.	Misioni i Mbikëqyrjes	5
II.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve	6
	1. Struktura e Tregut të Sigurimeve	6
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	6
	3. Analiza e Ecurisë dhe Rreziqeve të Tregut të Sigurimeve	9
III.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	12
	1. Struktura e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	12
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	13
	3. Treguesit Teknikë e Financiarë të Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare	14
IV.	Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve	15
	1. Struktura e Tregut të Fondeve të Investimeve	15
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Investimeve	15
	3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Fondeve të Investimeve 31.12.2018	19
V.	Anekse	21
	A. Tregu i Sigurimeve	21
	B. Tregu i Pensioneve Private Vullnetare	85
	C. Tregu i Fondeve të Investimeve	93
	D. Shoqëritë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	110



CONTENTS

I.	<i>Supervision Mission</i>	5
II.	<i>Report on the Financial Position of the Insurance Market</i>	6
	1. <i>Insurance Market Structure</i>	6
	2. <i>Insurance Market Supervision</i>	6
	3. <i>Analysis of the Performance and Risks of Insurance Market</i>	9
III.	<i>Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market</i>	12
	1. <i>Voluntary Private Pensions Market Structure</i>	12
	2. <i>Voluntary Private Pension Market Supervision</i>	13
	3. <i>Financial and Technical Indicators of the Voluntary Pension Fund Market</i>	14
IV.	<i>Report on the Financial Position of the Investment Fund Market</i>	15
	1. <i>Investment Funds Market Structure</i>	15
	2. <i>Investment Funds Market Supervision</i>	15
	3. <i>Key Indicators of the Investment Funds Market 31.12.2018</i>	19
V.	<i>Annexes</i>	21
	A. <i>Insurance Market</i>	21
	B. <i>Voluntary Private Pension Market</i>	85
	C. <i>Investment Funds Market</i>	93
	D. <i>Management Companies of Pension Funds and Collective Investment Undertakings</i>	110



I. Misioni i Mbikëqyrjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregjeve financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare në Shqipëri. AMF i ushtron funksionet mbikëqyrëse mbështetur në Ligjin nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2016. Ndryshimet dhe shtesat në këtë ligj synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së në përmbushje të objektivave të tij, nëpërmjet forcimit të pavarësisë dhe të përgjegjshmërisë së tij.

Misioni themelor i AMF-së, në zbatim të përgjegjësisë ligjore si autoritet mbikëqyrës, është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore në fuqi.

Edhe në vijim, AMF do të realizojë misionin e vet mbikëqyrës, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, bashkërendimit të analizës së dokumentacionit financiar dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit të procesit të mbikëqyrjes drejt mbikëqyrjes me fokus rreziku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimin të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrjeje efektive.

I. Supervision Mission

The Albanian Financial Supervisory Authority (AFSA) is a supervisory authority and an integrated regulator of the financial insurance, securities and voluntary private pensions markets in Albania. The AFSA exercises supervisory functions pursuant to Law no. 9572 dated 03.07.2006 “On the Financial Supervisory Authority” as amended by Law no. 54/2016. Amendments and additions to this law aim at the strengthening of the supervisory and regulatory role of the AFSA in meeting its objectives, by strengthening its independence and accountability.

The fundamental mission of AFSA, pursuant to legal responsibilities as a supervisory authority, is to protect the interests of consumers and investors, closely associated with the security of the supervised operators, ensuring compliance with the applicable legal provisions.

Further on, the AFSA will carry out its supervisory mission through continuous improvement of the supervisory regulatory framework in compliance with international principles and European directives, co-ordination of financial documentation analysis and on-site market supervision, orientation of the supervision process towards risk-based supervision, undertaking market development policies, and human resource training for an effective supervision.

II. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve

1. Struktura e Tregut të Sigurimeve

Tregu i sigurimeve më 31.12.2018 përbëhet nga 11 shoqëri sigurimesh. Në strukturën e tregut, tetë shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës dhe tre në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës kryen edhe aktivitet risigurimi. Bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë këtij viti vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga portofoli i MTPL së brendshme.

2. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve

Tregu i sigurimeve vijon me një ritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi, me total aktivesh që luhet në intervalin 1.8-2% e PBB-së për periudhën 2014-2017 dhe 1.95% e PBB-së në vitin 2018. Zgjerimi ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto, kryesisht në produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik. Por pavarësisht këtij zgjerimi të tregut të sigurimeve, pesha e tij në tregjet financiare që mbikëqyren nga AMF, është në nivele afërsisht të njëjta, përkatësisht 29.7%, 30.6% dhe 31.5% për vitet 2016-2018. AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregjet financiare të sigurimeve ka për mision të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë financiare. Kjo dikton nevojën e:

- Vijimit të zbatimit të masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosjes së standardeve të mire përcaktuara në lidhje me rezervat minimale, si dhe zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku;
- Forcimin e rregullave të administrimit të rrezikut në harmoni me evoluimin e rregullave të përshkuara në Direktivat përkatëse të BE-së, duke mbikëqyruar ngushtësisht respektimin e regjimit të informimit, aftësinë paguese, nivelet e likuiditetit, si dhe vlerësimin real të asetëve;

Gjatë vitit 2018 tregu shqiptar i sigurimeve pati një rritje nga pikëpamja e vëllimit total të primeve të shkruara bruto, të cilat kapën shifrën 16.93 miliardë lekë, duke u rritur afërsisht me 4.52% krahasuar me vitin 2017.

Në strukturë, tregu vazhdoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat zënë rreth 93.24% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, zënë 6.76% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2018, sigurimet vullnetare zunë 31.77% dhe ato të detyrueshme 68.23% të totalit të primeve të shkruara bruto. Në zbatim të kuarit rregullator ekzistues, edhe gjatë vitit 2018, AMF

II. Report on the Financial Position of the Insurance Market

1. Insurance Market Structure

The insurance market as of 31.12.2018 consists of 11 insurance companies. In the market structure, eight insurance companies exercise their activity in Non-Life insurance and three in Life insurance. One of the Non-Life insurance companies carries out reinsurance activities. Based on the technical account statement of Non-Life insurance companies, during this year it is noted that the insurance market continues to be dominated by the domestic MTPL portfolio.


2. Insurance Market Supervision

The insurance market continues at a relatively stable expansion rate, with total assets fluctuating in the range of 1.8-2% of the GDP for the period 2014-2017 and 1.95% of the GDP in 2018. The expansion is due to the increased volume of gross written premiums, mainly in compulsory motor insurance products. However, regardless of this expansion of the insurance market, its share in the financial markets supervised by the AFSA remains at a similar level, respectively 29.7%, 30.6% and 31.5% for the years 2016-2018. The mission of AFSA, as a supervisory and regulatory authority for the financial insurance markets, is to contribute to fostering financial sustainability. This dictates the need for:

- Continuation of the implementation of stabilization measures in the insurance market and the establishment of well-defined standards regarding minimum reserves, as well as the implementation of risk-based supervision;
- Strengthening of risk management rules in line with the evolution of the rules outlined in the relevant EU Directives, closely monitoring compliance with the information regime, solvency, liquidity levels, and real asset valuation;

During 2018, the Albanian insurance market grew in regard to the total volume of gross written premiums, which reached the figure of ALL 16.93 billion, increasing by approximately 4.52% compared to 2017.

With regard to the structure, the market continued to be oriented to Non-Life insurance, which accounts for 93.24% of the total volume of gross written premiums in the market. Whereas Life insurance occupy 6.76% of the total volume of gross written premiums. During 2018, voluntary insurance occupied 31.77% and the compulsory insurance 68.23% of the total gross written premiums. In compliance with the existing regulatory framework, during 2018, AFSA has also



ka mbikëqyrur dhe analizuar tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit. AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij.

Zhvillimi më i rëndësishëm me ndikim afatmesëm në tregun e sigurimeve mbetet vazhdimësia e zbatimit nga AMF të metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun duke pasur si synim forcimin e metodologjisë mbikëqyrëse për tregun e sigurimeve. Autoriteti në vitin 2018 përfundoi ciklin e parë të inspektimeve sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun për tregun e sigurimeve. Në vijim duke marrë në konsideratë nivelin e rrezikut që paraqesin siguruesit dhe elementë të tjerë si madhësia e tyre, në përputhje edhe me manualin e mbikëqyrjes do të vendosen prioritetet për alokimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe për inspektimet e mëtejshme.

Ajo që paraqet rëndësi është fakti që tashmë AMF ka në zbatim një paketë mbikëqyrjeje nëpërmjet së cilës do të përmirësohet procesi i vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve në kuadër të shoqërisë dhe të tregut në tërësi, duke rritur efektivitetin e procesit mbikëqyrës dhe marrjes së masave mbikëqyrëse. Metodologjia e mbikëqyrjes me fokus rrezikun, synon hartimin e një profili rreziku për shoqërinë e sigurimit, i cili përfaqëson vlerësimin nga ana e autoritetit mbikëqyrës në lidhje me fushat e rreziqeve specifike të shoqërisë, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve. Pjesë e kësaj metodologjie janë dhe fazat e ndërhyrjes nga ana e autoritetit mbikëqyrës, gjatë niveleve të ndryshme të rrezikut, ndërhyrje e cila ndryshon në vartësi të nivelit të rrezikut në një shoqëri sigurimi. Në kuadrin e zbatimit të kësaj metodologjie të mbikëqyrjes, AMF është duke punuar për ngritjen e një sistemi të paralajmërimit të hershëm, i cili do të vendosë prioritetet dhe drejtojë burimet rregullatore drejt atyre siguruesve që paraqesin profil më të lartë rreziku.

Metodologjia e mbikëqyrjes me fokus rrezikun, përveçse mbështetet në legjislacionin aktual, i cili krijon hapësirat e nevojshme ligjore për zbatimin e kësaj metodologjie, mbështetet edhe në sistemin e raportimit AMF In-Reg, që është platforma dhe kanali kryesor i raportimit të subjekteve të mbikëqyrura nga AMF. Në plan afatgjatë, ky sistem shërben si platforma kryesore mbështetëse e mbikëqyrjes me fokus rrezikun. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 ka vazhduar përfshirja e AMF-së në kolegjet mbikëqyrëse të grupeve financiare austriake të pranishme në Shqipëri, pasi kapitali austriak në tregun e sigurimeve në Shqipëri vazhdon të ketë një peshë të konsiderueshme.

Në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të grupeve u miratua Udhëzimi Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen

supervised and analysed the insurance market, assessing the financial position, results and technical indicators of the activity of insurance companies. The AFSA has consistently followed the fulfilment of the legal requirement on the guarantee fund of insurance companies and the implementation of its investment rules.

The most important development having a medium-term impact on the insurance market remains the continuation of AFSA's implementation of the risk-based Supervision Methodology aiming at strengthening the supervisory methodology for the insurance market. During 2018, AFSA completed first cycle of inspections under the supervision methodology, with special focus on the risk for the insurance market. In addition, taking into account the risk level posed by insurers as well as other elements such as their size, pursuant to the supervision manual, the priorities for allocating supervisory capacities and further inspections will be set.

It is essential that the AFSA already has under implementation a supervisory package through which will improve the process of risk assessment and monitoring of risks in the framework of the company and the market as a whole, by increasing the effectiveness of the supervisory process and taking of supervisory measures. The risk-based supervision methodology aims at designing a risk profile for the insurance company, which represents the assessment by the supervisory authority as regards the areas of the specific risks of the company, within the context of the insurance sector. The intervention phases undertaken by the supervisory authority at different levels of risk are also part of this methodology. Such phases vary depending on the level of risk at insurance companies. In the framework of implementing this supervisory methodology, the AFSA is working on setting up an early warning system, which will set priorities and orient regulatory resources to those insurers posing a higher risk profile.

The risk-based supervision methodology, besides relying on the actual legislation, which creates the necessary legal grounds for the implementation of this methodology, is also based on the AMF In-Reg reporting system, which is the platform and main reporting channel for the entities supervised by the AFSA. In the long term, this system serves as the main supporting platform of the risk-based supervision. Moreover, in 2018, the involvement of the AFSA in the supervisory colleges of the Austrian financial groups present in Albania, as the Austrian capital in the insurance market in Albania continues to have a significant share.

In view of a more effective groups' supervision, a methodological Directive “On insurance groups supervision”,

e grupit të sigurimit”, me Vendim Bordi nr. 250, datë 28.12.2018 dhe u krijuan Kolegjet Mbikëqyrëse Rajonale me pjesëmarrjen e 3 rregullatorëve AMF, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA) Maqedoni. Udhëzimi ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe formave specifike të një sistemi bashkëpunimi midis institucioneve mbikëqyrëse për të mundësuar një mbikëqyrje më efektive të grupeve të sigurimit si dhe duke pasur një qasje proaktive ndaj problematikave që mund të shfaqen nga grupet e sigurimit për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit të cilat kanë investime të tyre (filiale) apo degë në vende të huaja.

Për rregullimin ligjor të tregut të sigurimeve, gjatë vitit 2018, u hartuan dhe u miratuan rregulloret dhe udhëzimet si më poshtë:

- Rregullore nr. 56, datë 29.03.2018 “Mbi formën dhe përmbajtjen e detajuar të informimit të kreditorëve të njohur të shoqërisë së sigurimit”;
- Rregullore nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”;
- Udhëzim nr. 250, datë 28.12.2018 “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”;
- Manuali praktik mbi inspektimin në vend për dëmet motorike dhe të pronës, me Vendimin e Bordit nr. 97, datë 13.06.2018;
- Manuali praktik për mbikëqyrjen e veprimtarisë së risigurimit, me Vendimin e Bordit nr. 140, datë 30.07.2018.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 u hartuan dhe u miratuan shtesat dhe ndryshimet në rregulloret si më poshtë:

- Shtesa në Rregulloren nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve;
- Shtesa dhe ndryshimi i Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”;
- Ndryshimi i Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”;
- Ndryshimi në Rregulloren nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.

was adopted with Board's Decision no. 250, dated 28.12.2018 followed by the establishment of a Regional Supervisory Colleges with the participation of 3 regulatory bodies: AFSA, National Bank of Kosovo (NBK) and Macedonian Financial Supervisory Authority. The Directive aims at establishing the rules and specific forms of a co-operation system between supervisory institutions to enable a more effective supervision of the insurance groups and to employ a proactive approach to the problems that may arise from domestic insurance and reinsurance companies' insurance groups that have their investments (affiliates) or branches in foreign countries.

For the legal regulation of the insurance market, during 2018, the following regulations were drafted and approved:

- *Regulation no. 56, dated 29.03.2018, “On the form and detailed content of information about the insurance companies' known creditors”;*
- *Regulation no. 23, dated 26.02.2018 “On the on-line electronic register for the sales of compulsory motor insurance contracts”;*
- *Directive no. 250, dated 28.12.2018, “On insurance group supervision”;*
- *Practical Manual for Motor and Property Damage Inspection, with the Board's Decision no. 97, dated 13.06.2018;*
- *Practical manual on the supervision of reinsurance activity approved with the Board's decision no. 140, dated 30.07.2018.*

In addition, during 2018, the following additions and amendments to the regulations were drafted and adopted:

- *The addendum to the Regulation no. 36, dated 21.03.2012 “On the establishment, estimation, financing, management of the Compensation Fund and the payment of damages”;*
- *Additions and amendments to Regulation no. 53, dated 25.06.2009 “On loss treatment covered by compulsory insurance contract in the transport sector”;*
- *Amendment to Regulation no. 37, dated 28.05.2015 “On setting the criteria and requirements for the selection of the firm auditing the insurance companies”;*
- *Amendment to Regulation no. 2, dated 28.01.2010 “On the reporting and supervision standards of the Albanian Insurance Bureau”.*



3. Analiza e Ecurisë dhe Rreziqeve të Tregut të Sigurimeve

Ecuria e treguesve financiarë të tregut të sigurimeve për vitin 2018, shfaqet si më poshtë:

- **Totali i Primeve të Shkruara Bruto**, për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës për 31.12.2018 është 16.93 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 732 milionë lekë ose e përkthyer në përqindje në masën 4.52% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i një rritje të volumit të primeve të shkruara bruto në masën 792 milionë lekë ose 5.29% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës, ka shënuar një rënie prej 60 milionë lekë ose 5.03 %.
- **Raporti i Mjaftueshmërisë** së Kapitalit për tregun e Jo-Jetës në 31.12.2018 është 32.3%. Krahasuar me periudhën 31.12.2017. Ky raport si vlerë absolute e diferencës midis kapitalit të shoqërive dhe kapitalit të kërkuar, ka pësuar një rritje rënie prej 30 milionë lekë ose 1.1%. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i shtimit të kapitalit nga ana e shoqërive në një masë më të ulët se rritja e nivelit të kapitalit të kërkuar.
- **Treguesi i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike** për tregun e sigurimeve për periudhën 31.12.2018 është në masën 101.79%, duke shënuar rënie nga 103.91% në 31.12.2017. Për periudhën 31.12.2018 ky tregues për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës është 100.90%, duke u ulur nga 103.21% në fund të vitit 2017, ndërsa për tregun e Jetës është 109.38%, me një rënie të lehtë nga 109.72% që ishte në fund të vitit 2017.
- **Treguesit e Rentabilitetit ROE dhe ROA** për vitin 2018, janë përkatësisht ROE në nivelin 7.30% nga 9.56% në vitin 2017 dhe ROA 2.37% nga 3.03% në vitin 2017. Të dy këta tregues kanë pësuar rënie gjatë vitit 2018.
- **Totali i Aktivit të Tregut të Sigurimit** për periudhën 31.12.2018, sipas pasqyrave financiare, është 31.56 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 985 milionë lekë, ose 3.22% në krahasim me 31.12.2017. Kjo rritje është reflektuar kryesisht në zërat “Letra me vlerë të qeverisë”, “Toka dhe ndërtesa” dhe “Investime në sipërmarrje të kontrolluara”. Në total të tre zërat “Letra me vlerë të qeverisë”, “Toka dhe ndërtesa” si dhe “Investime në sipërmarrje të kontrolluara” për periudhën 31.12.2018 kanë pësuar rritje përkatësisht në masën 9%, 13% dhe 20% krahasuar me 31.12.2017, për shoqëritë e Jo-Jetës.

3. Analysis of the Performance and Risks of Insurance Market


The progress of the financial indicators of the insurance market for 2018 is shown as follows:

- **Total of Gross Written Premiums** for Life and Non-Life insurance market as of 31.12.2018 is ALL 16.93 billion, marking an increase of ALL 732 million or 4.52% compared to the previous year. Such increase is due to the increase of the gross written premiums volume by ALL 792 million or 5.29% for the Non-Life insurance market. The Life insurance market decreased by ALL 60 million or 5.03%.
- **The Capital Adequacy Ratio** for the Non-Life market as of 31.12.2018 is 32.3%. Compared to the period up to 31.12.2017. This ratio, as an absolute value of the difference between the capital of the companies and the required capital, has decreased by ALL 30 million or 1.1%. This increase was the consequence of the lower increase of the companies' capital compared to the increase of the required capital.
- **The Indicator of Assets covering Technical Provisions** for the insurance market for the period of 31.12.2018 is 101.79%, marking a decrease as of 103.91% on 31.12.2017. For the period of 31.12.2018, this indicator for the Non-Life insurance market is 100.90%, marking a decrease compared to 103.21% at the end of 2017, whereas for the Life Insurance market, it is 109.38%, marking a light decrease compared to 109.72% in 2017.
- **ROE and ROA Profitability Indicators** for 2018 are respectively ROE 7.30% from 9.56% in 2017 and ROA 2.37% from 3.03% in 2017. Both indicators have decreased during 2018.
- **Total Assets of the Insurance Market** for the period of 31.12.2018, according to the financial statements, amount to ALL 31.56 billion, marking an increase of ALL 985 million or 3.22% compared to 31.12.2017. This growth is mainly reflected in the items “Government Securities”, “Land and Buildings” and “Investments in controlled undertakings”. In total, the three items “Government Securities”, “Land and Buildings” and “Investments in controlled undertakings” for the period of 31.12.2018, respectively increased by 9%, 13% and 20% compared to 31.12.2017, for Non-Life insurance companies.

- Në periudhën 31.12.2018 vihet re një rritje e zërit të Provigjoneve Teknike Bruto. Në nivel tregu rritja në Provigjonet Teknike Bruto është në masën 3.49% ose në vlerën 553 milionë lekë në krahasim me 31.12.2017.
- Rezultati financiar neto i tregut të sigurimeve për vitin 2018 është pozitiv në vlerën 748 milionë lekë. Ky rezultat krahasuar me periudhën e kaluar ka një rënie me 18%. Të dy tregjet e sigurimeve kanë pësuar rënie, konkretisht 160 milionë lekë ose 22% për tregun e Jo-Jetës dhe 5 milionë lekë ose 3% për tregun e Jetës.
- Tregu i sigurimeve të Jetës vijon të ketë ritme të qëndrueshme rritjeje, duke shënuar rezultat teknik pozitiv, në vlerën 255 milionë lekë. Tregu i Jo-Jetës regjistron një rezultat teknik pozitiv, në vlerën 537 milionë lekë për vitin 2018, krahasuar me rezultatin e vitit 2017 është ulur me 148 milionë.
- Niveli ende i ulët i **Raportit të Primeve të Shkruara Bruto ndaj PBB**, në masën 1.05%, vazhdon të përforcojë pritshmërinë se tregu shqiptar i sigurimeve paraqet potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm.
- *During the period up to 31.12.2018, an increase of the item Gross Technical Provisions is noted. At market level, such increase in Gross Technical Provisions is equal to 3.49% or ALL 553 million as compared to 31.12.2017.*
- *The net financial result of the insurance market for 2018 is positive at the amount of ALL 748 million. Compared to the previous period, this result shows a decrease of 18%. Both insurance markets have decreased, specifically ALL 160 million or 22% for the Non-Life market and ALL 5 million or 3% for the Life market.*
- *The Life insurance market continues to have stable growth rates, marking a positive technical result, at the amount of ALL 255 million. The Non-Life insurance market marks a positive technical result, at the amount of ALL 537 million for 2018, which compared to 2017's result has decreased by ALL 148 million.*
- *The level of **Gross Written Premiums to GDP ratio** which remains low at 1.05%, continues to reinforce the expectation that the Albanian insurance market represents great potential for further development.*

Grafik: Aktivitet në Mbulim të Provigjoneve Teknike
Graph: Assets Covering Technical Provisions

(Në %)



Gjatë vitit 2018 kanë vazhduar të përdoren testet e paralajmërimit të hershëm (EWT) për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në Shqipëri. Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit të problemeve që mund të bëhen shkak për përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve

The Early Warning Test (EWT) for Non-Life insurance companies in Albania continued to be used during 2018. These financial indicators serve to identify issues that may cause the deterioration of one or more parameters of market operators. Maintaining the sustainability of



në treg. Ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe mbrojtja e konsumatorit janë ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së AMF-së. Veprimet e Autoritetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në këtë drejtim, përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato zona, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Gjatë vitit 2018, rekomandimet që AMF ka dhënë lidhen kryesisht me:

- Rënien e aftësisë paguese të disa shoqërive nën nivelin e kufirit minimal të aftësisë paguese të përcaktuar ligjërisht, sipas dispozitave të nenit 80 të Ligjit 52/2014;
- Rënia e treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike nën nivelin minimal të përcaktuar ligjërisht, sipas dispozitave të nenit 96 të Ligjit 52/2014;
- Plotësimin e kërkesave të Bordit të AMF-së në lidhje me pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare dhe shlyerjen e detyrimeve që lidhen me dëmet e Fondit të Kompensimit;
- Administrimin e rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
- Vonesat në depozitimin e Raportit të Audituesit të Jashtëm për disa shoqëri Sigurimi;
- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve, si edhe zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të provigjonimit të dëmeve në proces gjyqësor, për një pasqyrim sa më të drejtë të nivelit të rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë;
- Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Fondi i Garancisë është investuar në “depozita qëllimore” në banka të nivelit të dytë dhe Bono Thesari, sipas kërkesave të ligjit.

financial markets under supervision and consumer protection are among the main objectives of AFSA's activity. The actions of the Authority in order to prevent and eliminate violations in this regard include monitoring of market practices on a continuous basis and intervention with particular emphasis on those areas that are exposed to high risk or in terms of protecting consumer interests.

During 2018, the recommendations provided by AFSA mainly relate to:

- *Decrease of solvency of some companies below the minimum solvency margin level defined by law, as provided for in Article 80 of Law 52/2014;*
- *Decrease of the asset's indicators covering technical provisions below the minimum margin defined by law, as provided for in Article 96 of Law 52/2014;*
- *Fulfilment of the AFSA Board requirements regarding the accurate reflection in the financial statements and settlement of claims related to the Compensation Fund claims;*
- *Management of risks contracted by insurance companies in compliance with the applicable legal requirements;*
- *Delays in filing the External Auditor's Report for some Insurance Companies;*
- *Evaluation and handling of claims, as well as compliance with the legal requirements for the provision of claims in court proceedings, for a fair reflection of the level of risk contracted by companies;*
- *Reporting of the required information to the Authority in compliance with the applicable legal requirements;*

The AFSA has consistently followed the fulfilment of the legal requirement on the guarantee fund of insurance companies and the implementation of its investment rules. The Guarantee Fund is invested in “target deposits” in second tier banks and Treasury Bills, as required by law.

III. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

1. Struktura e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare përbëhet nga tre fonde pensioni, të cilat administrohen nga tri shoqëri të ndryshme administrimi.

- Shoqëria administruese e fondeve të pensionit dhe SIK Raiffeisen Invest sh.a. administron një fond pensioni i cili është Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, miratuar me VB të AMF Nr. 107, datë 18.10.2010 dhe tre fonde investimi, të cilët janë Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, miratuar me VB të AMF Nr. 180, datë 13.12.2011, Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro miratuar me VB të AMF Nr. 135, datë 26.09.2012 dhe Fondi i Investimit Raiffeisen Vizion miratuar me VB të AMF-së nr. 143, datë 30.07.2018.

Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryen Banka e Parë e Investimeve, e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me VB Nr. 80, datë 30.08.2010 miratuar me VB të AMF Nr. 143, datë 30.07.2018.

- Shoqëria administruese e fondeve të pensionit Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a. është licencuar si e tillë me Vendim Bordin AMF Nr. 50, datë 30.03.2011. Ajo aktualisht administron vetëm një fond pensioni i cili është Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, miratuar me Vendim Bordin të AMF nr. 51, datë 30.03.2011.

Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryen "Banka Amerikane e Investimeve" sh.a., e cila është licencuar nga AMF-ja për të kryer funksionin e depozitarit me Vendim Bordin nr. 5 dt. 03.07.2017.

- Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit dhe SIK "Credins Invest" sh.a. është licencuar fillimisht si shoqëri administruese e fondeve të pensionit e njohur nën emrin "SiCRED" sh.a. me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 156, datë 23.11.2011. Nëpërmjet Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 85, datë 30.05.2016 u miratua licencimi i kësaj shoqërie për të kryer edhe veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive nën emrin e ri "Credins Invest" sh.a.

Kjo shoqëri aktualisht administron fondin e pensionit vullnetar "Sicred Pensions", miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 173, datë 13.12.2011 dhe fondin e investimit "Credins Premium", miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 86, datë 30.05.2016. Për këtë shoqëri, funksionin e depozitarit e kryejnë Tirana Bank dhe Banka e Parë e Investimeve¹.

¹ Në datë 02.02.2018, për fondin Credins Premium, shërbimi i depozitarit është transferuar nga First Investment Bank sh.a. në American Bank of Investments sh.a.

III. Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market

1. Voluntary Private Pensions Market Structure

The structure of the voluntary private pension market consists of three pension funds, which are managed by three different management companies.

- The Pension Fund Management Company and CIU Raiffeisen Invest sh.a. manages a pension fund that is the Raiffeisen Voluntary Pension Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 107, dated 18.10.2010 and two investment funds, which are the Raiffeisen Prestige Investment Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 180, dated 13.12.2011 and the Raiffeisen Invest Euro Investment Fund approved by the AFSA Board Decision no. 135, dated 26.09.2012 and Raiffeisen Vision Investment Fund approved by the AFSA Board Decision no. 143, dated 30.07.2018.

For this company, the depository function is performed by the First Investment Bank, which is licensed by the AFSA to perform the function of the depository by Board Decision no. 80, dated 30.08.2010 approved by the AFSA Board Decision no. 143, dated 30.07.2018.


- The Pension Fund Management Company Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a. is licensed as such by the AFSA Board Decision no. 50, dated 30.03.2011. It currently manages only one pension fund which is the Sigal Voluntary Pension Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 51, dated 30.03.2011.

For this company, the function of the depository is performed by Tirana Bank, which is licensed by the AFSA to perform the function of the depository by Board Decision no. 5 dated 03.07.2017.

- The Pension Fund Management Company and CIU "Credins Invest" sh.a. was initially licensed as a pension fund management company known under the name "SiCRED" sh.a. by AFSA Board Decision no. 156, dated 23.11.2011. Through the AFSA Board Decision no. 85, dated 30.05.2016, the licensing of this company was approved to perform asset management activities of collective investment undertakings under the new name "Credins Invest" sh.a.

Currently, this company manages the voluntary pension fund "Sicred Pensions", approved by the AFSA Board Decision no. 173, dated 13.12.2011, and the "Credins Premium" investment fund, approved by the AFSA Board Decision no. 86, dated 30.05.2016. For this company, the function of the depository is performed by Tirana Bank and First Investment Bank¹.

¹ On 02.02.2018, the deposit service for the Credins Premium fund was transferred from First Investment Bank sh.a. at American Bank of Investments sh.a.



2. Mbiqëyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

Mbiqëyrja e Tregut të pensioneve private vullnetare ushtrohet nga AMF mbështetur në Ligjin 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëyrjes Financiare”, ndryshuar me Ligjin 54/2014, si dhe Ligjin 10197 datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Qëllimi i ligjit për fondet e pensionit vullnetar është të vendosë standardet e nevojshme për:

- Administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit;
- Mbiqëyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit;
- Nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aseteve të fondit të pensionit;
- Licencimin dhe mbiqëyrjen e shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe planit të pensionit profesional, të depozitarit të aseteve të fondeve të pensionit dhe të të gjitha çështjeve të lidhura me to.

Në kuadrin e metodologjisë mbiqëqyrëse me bazë rrezikun, gjatë vitit 2018 u krye inspektimi në vend pranë njëres prej njësive të depozitarit të fondeve të pensionit dhe investimit. Objekti i këtij inspektimi ishte vlerësimi i nivelit të rreziqeve të njësive të depozitarit mbështetur në parimet me të cilat duhet të përputhet aktiviteti i tij. Këto parime janë pjesë e zbatimit të metodologjisë së re mbiqëqyrëse për fondet e pensioneve vullnetare, asaj me bazë rreziku, e cila u hartua dhe u miratua në vitin 2016. Nëpërmjet kësaj metodologjie evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Metodologjia me bazë rrezikun, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2016 me miratimin e Metodologjisë së re mbiqëqyrëse. Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2018 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe u dakordësua vlerësimi i këtyre rreziqeve, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua rritja e pjesëmarrjes së kontribuuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti

2. Voluntary Private Pension Market Supervision

The supervision of the Voluntary Private Pensions Market is exercised by the AFSA based on Law No. 9572 dated 03.07.2006 “On the Financial Supervisory Authority”, as amended by Law 54/2014, and Law 10197, dated 10.12.2009 “On Voluntary Pension Funds”; as well as the by-laws for its implementation. The purpose of the Law on Voluntary Pension Funds is to establish the necessary standards for:

- Effective management of voluntary pension funds, through diversification of investments, with the aim of increasing the contributions made to the pension fund;
- Supervision of the voluntary pension fund business with defined contributions in order to ensure the protection of the pension fund member;
- Promotion of sustainability, security and good governance of the pension fund assets;
- Licensing and supervision of the pension fund management company and the professional pension plan, the depository of the pension fund assets and all related matters.

In the framework of the risk-based supervisory methodology, on-site inspection was carried out during 2018, at one of the pensions and investment funds depository units. The scope of this inspection was to assess the risk level of the depositor unit, based on the principles upon which its activity should conform. These principles are an integral part of the implementation of the new supervisory methodology for voluntary pension funds, risk-based supervision which was drafted and adopted in 2016. This methodology identifies the greatest risks affecting this market and simultaneously, the strategies to be followed for mitigating such risks to an acceptable level.

The risk-based methodology, with a view to developing a sound process for judging risk assessment, has also foreseen the establishment of the Risk Committee for Pension Fund, which started its activity in 2016 with the adoption of the new Supervisory Methodology. During the 2018 Risk Committee meetings, were presented the present and residual risk matrix in the system, and it was agreed to assess these risks, thus identifying risks requiring faster system interventions. Therefore, the greatest risk identified in the situation of Albania was the increase of the participation of contributors in the system, which is also related to the increase of credibility in the system. The Risk

i Rrezikut, duke pasur si objektiv zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

3. Treguesit Teknikë e Financiarë të Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare

Tregu i pensioneve shfaqet më modest në krahasim me dy tregjet e tjera. Megjithatë, ky treg ka shfaqur një dinamikë më të lartë rritjeje, veçanërisht në lidhje me numrin e anëtarëve. Në 2018, totali i asetëve neto të fondeve të pensioneve private u rrit me 32.51% dhe numri i anëtarëve me 20.77% në krahasim me vitin 2017.

Zhvillim i rëndësishëm në këtë treg që nga viti 2015 ishte përfshirja e nxitësve të përshtatshëm fiskalë. Kështu, në paketën fiskale të vitit 2015 (parashikuar nga Ligji nr. 156/2014), kontributet e punëdhënësit dhe punëmarrësit në skemat e fondeve të pensionit njihen si të ardhura të patatueshme, deri në kufijtë e përcaktuar nga ligji dhe pasqyrohen në listëpagesat).

Gjatë vitit 2018, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2018 tregon një total të aktiveve neto prej 2,289.1 milionë lekë me një rritje prej afro 561.56 milionë lekë (32.51%) krahasuar me fundin e vitit 2017.

Në 31.12.2018 investimet e tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Vlera e investimeve të këtij tregu në 31.12.2018 është 2,210,160,129 lekë duke zënë një peshë prej 95.96% ndaj totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit. Krahasuar me 31.12.2017 këto investime janë rritur me 34.62%. Gjatë vitit 2018, investimet e tregut të fondeve të pensioneve përbëhen nga Obligacione thesari të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 3, 5, 7 dhe 10 vjeçar. Në total tregu, investimet në Obligacione të qeverisë së R.Sh. me afat maturimi 7 vjeçar dhe 10 vjeçar janë ato që zënë peshën më të madhe dhe përbëjnë respektivisht 32.86% dhe 56.70% të totalit të totalit të investimeve të këtij tregu.

Shoqëritë administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen Invest sh.a., Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a dhe Credins Invest sh.a, e publikojnë dhe e përditësojnë vlerën e kuotës së pensionit duke zbatuar bazën ligjore në fuqi.

Në Aneksin “Tregu i Pensioneve Private Vullnetare 31.12.2018”, jepet informacion i detajuar për tregun e fondeve të pensioneve.

Committee, aiming at mitigating risks, adopted a medium-term supervision plan for the pension funds market.

3. Financial and Technical Indicators of the Voluntary Pension Fund Market

The pension market appears more modest compared to the other two markets. However, this market has shown a higher growth dynamic, especially with regard to the number of members. In 2018, the total net assets of private pension funds increased by 32.51% and the number of members by 20.77% compared to 2017.


A significant development in this market was the inclusion of appropriate fiscal incentives in the 2015 fiscal package. Thus, in the 2015 fiscal package (provided for in Law No. 156/2014) the employer and employee contributions to the pension fund schemes are recognized as non-taxable income, up to the limits defined by law, and are reflected in the payroll.

During 2018, three pension funds exercised their activity in the voluntary private pension market. The analysis of the data on the voluntary private pension market as of 31.12.2018 shows a total of net assets of ALL 2,289.1 million, marking an increase of approximately ALL 561.56 million (32.51%) compared to the end of 2017.

As of 31.12.2018, the investments of the Voluntary Pension Funds market are in line with the applicable legal basis. The investment value of this market as of 31.12.2018 is ALL 2,210,160,129, accounting for a share of 95.96% of the total assets of the pension fund market. Compared to 31.12.2017, these investments have increased by 34.62%. During 2018, the investments in the Pension Fund Market consist of Treasury Bonds of the Republic of Albania with a maturity term of 3, 5, 7 and 10 years. In the total market, investments in Government Bonds of the Republic of Albania with a maturity term of 7 years and 10 years are those that occupy the largest share and respectively account for 32.86% and 56.70% of the total assets of this market.

The Pension Fund Management Companies Raiffeisen Invest sh.a, Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a and Credins Invest sh.a publish and update the value of the pension shares in accordance with the applicable legal basis.

Appendix “Voluntary Private Pensions Market 31.12.2018”, provides for detailed information on the pension fund market.



IV. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve

1. Struktura e Tregut të Fondeve të Investimeve

Struktura e tregut të Fondeve të Investimeve deri në 31.12.2018 përbëhet nga pesë fonde investimi të cilët janë:

- Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 180, datë 13.12.2011;
- Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 135, datë 26.09.2012;
- Fondi i Investimit Credins Premium, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 86, datë 30.05.2016;
- Fondi i Investimit WVP Top Invest, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 14, datë 31.01.2018, dhe
- Fondi i Investimit Raiffeisen Vizion, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 143, datë 30.07.2018.

Fondet e Investimit Raiffeisen Prestigj, Raiffeisen Invest Euro dhe Raiffeisen Vizion administrohen nga SHAFP dhe SIK Raiffeisen Invest sh.a., Fondi i Investimit Credins Premium administrohet nga SHAFP dhe SIK Credins Invest sh.a. dhe fondi WVP Top Invest administrohet nga SIK WVP Fund Management Tirana sh.a.

Për fondet e investimi të administruar nga shoqëria Raiffeisen Invest sh.a. dhe për fondin e investimit të administruar nga shoqëria WVP Fund Management Tirana sh.a. funksionin e depozitarit e kryen Banka e Parë e Investimeve, e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me VB nr. 80, datë 30.08.2010, ndërkohë që për fondin e investimit të administruar nga shoqëria Credins Invest sh.a. funksionin e depozitarit e kryen American Bank of Investments sh.a. e cila është licencuar nga AMF për të kryer funksionin e depozitarit me Vendimin e Bordit nr. 5, datë 03.07.2017.

2. Mbiqëqyrja e Tregut të Fondeve të Investimeve

Mbiqëqyrja e Tregut të fondeve të investimit ushtrohet nga AMF mbështetur në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe Ligjin 10198 datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Qëllimi i ligjit për fondet e investimeve kolektive është të rregullojë:

IV. Report on the Financial Position of the Investment Fund Market

1. Investment Fund Market Structure

The Investment Fund Market structure as of 31.12.2018 consists of three investment funds, which are:

- Raiffeisen Prestige Investment Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 180, dated 13.12.2011;
- Raiffeisen Invest Euro Investment Fund approved by the AFSA Board Decision no. 135, dated 26.09.2012;
- Credins Premium Investment Fund approved by the AFSA Board Decision no. 86, dated 30.05.2016;
- WVP Top Invest Investment Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 14, dated 31.01.2018, and
- Raiffeisen Vision Investment Fund, approved by the AFSA Board Decision no. 143, dated 30.07.2018.

Raiffeisen Prestige, Raiffeisen Invest Euro and Raiffeisen Vision Investment Funds are managed by the PFMC and CIU Raiffeisen Invest sh.a., whereas the Credins Premium Investment Fund is managed by the PFMC and CIU Credins Invest sh.a. and WVP Top Invest Investment Fund is managed by CIU WVP Fund Management Tirana sh.a.

